




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA



|                            |                 |         |       |
|----------------------------|-----------------|---------|-------|
| Prapuar - Priljena Me/Dena |                 |         |       |
| 31.07.2015                 |                 |         |       |
| Nr. l. urpant:             | Num. l. urpant: | Shitose | Vlera |
| Org. broj                  | Num. l. urpant  | Shitose | Vlera |
| 01-013/1064                |                 |         |       |

Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

**RREGULLORE**  
**PËR KOMITETET KONSULTATIVE PËR SIGURIMIN E PJESËMARRJES SË**  
**QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE NË KOMUNËN E VITISË**

Viti, Korrik 2015

Në mbështetje të nenit 12.2 pika c), dhe nenit 73 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28 2008), duke u bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/10 për organizimin dhe funksionimin e Komiteteve Konsultative në komuna, të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, të datës 15 korrik 2008, dhe nenin nenit 36.2 pika c) lidhur me nenin 46.3, të Statutit të Komunës së Vitisë, 01 - 013/491, 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur me 30.07.2015 aprovon këtë:

## **RREGULLORE**

### **PËR KOMITETET KONSULTATIVE PËR SIGURIMIN E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE NË KOMUNËN E VITISË**

#### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1** **Qëllimi**

1. Kjo Rregullore ka për qëllim që përmes krijimit të Komiteteve Konsultative:
- 1.1. Të rris pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në Komunën e Vitisë;
- 1.2. Të ndikojë tek qytetarët dhe grupet e tjera të interesit të marrin pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes për interes publik;
- 1.3. Të garantohet që të gjitha organet e Komunës së Vitisë të gëzojnë legjitimitet dhe transparencë më të madhe, të jenë më efikase dhe t'i japin më shumë llogari qytetarëve të Komunës së Vitisë, si dhe
- 1.4. Të sjellin vendimmarrjen më afër qytetarëve për të promovuar qeverisje të mirë dhe kushte të jetesës më të mirë për të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë, duke i kushtuar kujdes përkatës nevojave të posaçme dhe brengave të komuniteteve jo shumicë në Komunën e Vitisë.

##### **Neni 2** **Fushëveprimi**

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra dhe kushtet e themelimit të Komiteteve Konsultative si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të këtyre Komiteteve në Komunën e Vitisë.

##### **Neni 3** **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:
  - 1.1. **Ligj** - Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 4 qershor 2008);
  - 1.2. **Statut**- Statuti i Komunës së Vitisë, 01 -013/491 i datës 21.04.2011;
  - 1.3. **Kuvendi** – Kuvendi i Komunës së Vitisë;
  - 1.4. **Kryetari** – Kryetari i Komunës së Vitisë;
  - 1.5. **Kryesuesi**- Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë;
  - 1.6. **Qytetarë** - Qytetar i komunës së Vitisë është çdo person i cili është qytetar i përhershëm i Republikës së Kosovës që jeton në komunën e Vitisë.

- 1.7. **Komitetet-Komitetet Konsultative** - komitetet këshillëdhënëse sektoriale me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes;
- 1.8. **Komitetet e përhershme** - Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete, siç përcaktohen në Nenin 41.1 të Statutit.
- 1.9. **Anëtar i Komitetit Konsultativ** – në qoftë se konteksti nuk e kërkon ndryshe nënkupton Kryesuesin, Zëvendës kryesuesin, dhe anëtarët e Komitetit.
2. Termat tjera të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, dhe Statutin e Komunës së Vitisë.

**II. KOMPETENCAT DHE THEMELIMI I KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR SIGURIMIN E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE NË KOMUNËN E VITISË**

**Neni 4**

**Kompetencat e Komiteteve Konsultative**

1. Komitetet Konsultative mund të dorëzojnë propozime, bëjnë hulumtime dhe ofrojnë mendime, këshilla dhe sugjerime për iniciativat e Kuvendit, në pajtim me Statutin. Në këtë drejtim, Komitetet Konsultative:
- 1.1. japin propozime për rregullore të ndryshme komunale;
  - 1.2. japin mendime dhe ide, në fushën përkatëse, rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari, Kuvendi apo Komitetet e përhershme.
  - 1.3. mund të bëjnë propozime, këshilla dhe sugjerime për përmirësimin, apo zgjidhjen e problemeve të identifikuara.
2. Komitetet Konsultative, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, të përcaktuara në paragrafin një (1) të këtij neni, duhet t'i paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve tek Kryetari dhe në Kuvend.
3. Propozimet e Komiteteve Konsultative nuk janë obligative për Kryetarin dhe Kuvendin, por duhet të merren parasysh në zhvillimin e politikave komunale. Propozimet e Komiteteve Konsultative nuk janë obligative për Kuvendin, por duhet të merren parasysh në zhvillimin e politikave komunale.

**Neni 5**

**Themelimi i Komiteteve Konsultative**

Kuvendi mund të themelojë komitetet këshillëdhënëse sektoriale me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në të gjitha fazat e procesit vendimmarrës, duke filluar nga planifikimi, diskutimi, marrja e vendimit, zbatimi dhe monitorimi.

**Neni 6**

**Propozimet për themelimin e Komiteteve Konsultative**

1. Propozimet për themelimin e Komiteteve Konsultative bëhen nga Kryetari.
- 1.1. Kryetari dhe nga
  - 1.2. Anëtarët e Kuvendit.
2. Propozimet e subjekteve të përcaktuara në paragrafin një (1) të këtij neni, së bashku me arsyetimin përkatës, i drejtohen Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

**Neni 7**

**Propozimi për themelimin e Komiteteve Konsultative nga Kryetari**

Kryetari mund të propozojë për miratim në Kuvend nismën për themelimin e Komiteteve Konsultative, në pajtim me procedurat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

**Neni 8**  
**Propozimi për themelimin e Komiteteve nga Anëtari i Kuvendit**

Anëtari i Kuvendit mund të propozoj për miratim në Kuvend nismën për themelimin e Komiteteve Konsultative, në pajtim me procedurat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

**Neni 9**  
**Propozimi për themelimin e Komiteteve Konsultative nga Grupi i Qytetarëve**

1. Të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë, kanë të drejtë që të marrin pjesë në aktivitetet e komunës dhe kanë të drejtë që të ndërmarrin iniciativën për propozimin e themelimit të Komiteteve Konsultative.
2. Propozimi për themelimin e Komiteteve Konsultative, duhet të nënshkruhet nga së paku tridhjetë (30) votues të regjistruar të Komunës.
3. Çdo propozim nga qytetarët, për themelimin e Komiteteve Konsultative, duhet të ketë përfaqësuesin i cili është pika e kontaktit dhe komunikimit me institucionet komunale.
4. Verifikimin e listës së nënshkruar, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, e bënë shërbimi i administratës komunale.
5. Grupi i Qytetarëve, kërkesën për themelimin e Komiteteve Konsultative duhet t'ia drejtojë Kryetarit. Nëse Kryetari e miraton propozimin e Grupit të Qytetarëve ia paraqet Kryesuesit të Kuvendit.

**Neni 10**  
**Themelimi i Komiteteve Konsultative Ad Hoc**

1. Kuvendi i Komunës së Vitisë mund të themelojë Komitete Konsultative Ad Hoc, për çështje të caktuara, e që mandati i tyre pushon pas përfundimit të çështjes për të cilën është themeluar.
2. Propozimet për themelimin e Komiteteve Konsultative ad hoc, për çështje të caktuara, bëhen nga Kryetari dhe Anëtarët e Kuvendit.
3. Në Vendimin për themelimin e Komiteteve Konsultative ad hoc përcaktohet çështja e themelimit si dhe koha e përfundimit të mandatit të tyre.
4. Mënyra e propozimit të themelimit dhe funksionimit të Komiteteve Konsultative ad hoc është e njëjtë me Komitetet Konsultative, me përjashtim të përcaktimit të afatit kohor për të cilin themelohen këto komitete.

**Neni 11**  
**Votimi për themelimin e Komiteteve Konsultative**

Themelimi i secilit Komitet Konsultativ, duke përfshirë edhe komitetet konsultative ad hoc, si dhe ndryshimi i anëtareve të këtyre Komiteteve, kur të jetë e nevojshme, bëhet me votimin e shumicës së thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në Kuvend, në takimin në të cilën shqyrtohet propozimi.

**Neni 12**  
**Refuzimi i propozimit**

1. Kuvendi, refuzon propozimin për themelimin e Komiteteve Konsultative në rastet kur nisma:
  - 1.1. është kundër parimeve themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit dhe Statutit;

- 1.2. nuk propozohet nga subjektet e përcaktuara në këtë rregullore, dhe
- 1.3. nuk i përmban kushtet dhe kriteret e përcaktuar me këtë rregullore.

### **Neni 13** **Shpallja e Konkursit**

1. Kuvendi pas marrjes së vendimit për themelimin e Komitetit Konsultativ, themelon edhe panelin përzgjedhës, i cili duhet të ketë në përbërje të tij dy (2) anëtarë nga Kuvendi dhe nga një (1) anëtar nga shoqëria civile.
2. Kuvendi shpall konkurs publik për anëtarësimin në komitetin përkatës konsultativ duke përcaktuar kriteret për konkurrim/anëtarësim.
3. Kuvendi nëpërmjet mjeteve të informimit publik (mediave të shkruara dhe elektronike) dhe kampanjave të ndryshme duhet të sensibilizojë opinionin për afatin për aplikim, mënyrën dhe vendet e aplikimit.
4. Paneli përzgjedhës pas shpalljes publike do të bëjë përzgjedhjen e anëtarëve përmes konkursit publik, dhe pas intervistimit do t'i propozojë Kuvendit listën me anëtarët për Komitet.

### **Neni 14** **Zgjedhja e anëtarëve të rinj**

Procesi i zgjedhjes së anëtarëve të rinj që zëvendësohen, që japin dorëheqje apo anëtarëve të shkarkuar, është i njëjtë me mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve të Komitetit Konsultativ sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.

## **III. ANËTARËSIMI NË KOMITETET KONSULTATIVE**

### **Neni 15** **Parimet e përgjithshme për anëtarësim në Komitetet Konsultative**

- Në emërimin e anëtarëve të këtyre komiteve, Kuvendi duhet të sigurojë:
- 1.1. Të jenë qytetarë të komunës dhe/apo përfaqësuesi i organizatave joqeveritare që veprojnë dhe janë aktive në komunë;
  - 1.2. një përfaqësim të gjerë të ndryshëm të shoqërisë;
  - 1.3. të merret parasysh balanca gjinore duke përfshirë kuotën 30%, duke përfshirë pjesëtarët e popullsisë jo shumicë, në proporcion të përfaqësimit të tyre në Komunë, dhe
  - 1.4. duhet të reflektojnë interesat e komuniteteve ekzistuese dhe apo të fshatrave brenda komunës.

### **Neni 16** **Anëtarësimi në Komitetet Konsultative**

Anëtarësimi në Komitetet Konsultative bëhet nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të Komunës së Vitisë, të cilët njëherë duhet të jenë njohës të fushave përkatëse apo anëtar i organizatës e cila merret me atë fushë veprimtari, si dhe të plotësojë kriteret tjera që përcaktohen në konkurs, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 17** **Mandati i anëtarëve të Komiteteve Konsultative**

1. Anëtarët e Komitetit Konsultativ zgjidhen me mandat 3 (tre) vjeçar me mundësi edhe të rizgjedhjes edhe një herë.

2. Asnjë anëtar i Komitetit Konsultativ nuk mund të shërbejë më shumë se në dy mandate të njëpasnjëshme.

#### **IV. FUNKSIONIMI DHE ORGANIZIMI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV**

##### **Neni 18**

##### **Përbërja e Komitetit Konsultativ**

1. Komiteti Konsultativ përbëhet prej më së paku pesë (5) anëtar dhe më së shumti shtatë (7) anëtar.
2. Komiteti, nga radhët e veta, zgjedh kryesuesin dhe zëvendës kryesuesin.
3. Zgjedhja e kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit.

##### **Neni 19**

##### **Kryesuesi i Komitetit Konsultativ**

1. Kryesuesi i Komitetit Konsultativ ka këto kompetenca:
  - 1.1. Organizon dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës së përgjithshme të Komitetit;
  - 1.2. përgjigjet për veprimtarinë e Komitetit;
  - 1.3. kryen dhe ndërmerr veprime në të mirë të punës së Komitetit;
  - 1.4. përfaqëson Komitetin në kontakt me publikun si dhe me organe komunale;
  - 1.5. në koordinim me anëtarët të Komitetit Konsultativ përgatit planin e punës;
  - 1.6. koordinon veprimtarin, përcakton punën dhe detyrat për anëtarët e Komitetit Konsultativ;
  - 1.7. thërret takimet dhe kujdeset për mbarëvajtjen e tyre;
  - 1.8. sipas nevojës përgatit raportin të cilin e miraton Komiteti para se ta dërgohet në Kuvend;
  - 1.9. Thërret dhe kryeson takimet e Komitetit Konsultativ;
  - 1.10. Kryen detyra tjera të cilat ia beson Komiteti.

##### **Neni 20**

##### **Zëvendës kryesuesi i Komitetit Konsultativ**

Zëvendës kryesuesi i Komitetit e ndihmon Kryesuesin e Komitetit në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tij, si dhe e zëvendëson kryesuesin në mungesë të tij.

##### **Neni 21**

##### **Anëtarët e Komitetit Konsultativ**

1. Anëtarët e Komitetit Konsultativ janë të obliguar të marrin pjesë në takimet e Komitetit.
2. Anëtarët e Komitetit Konsultativ angazhohen për zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi në përputhje me mandatin dhe planin e punës të aprovuar nga Komiteti.
3. Komiteti Konsultativ njofton Kuvendin për planin e tij të punës.
4. Anëtari i Komitetit Konsultativ ka të drejtë që nëpërmjet Kryesuesit të Komitetit të kërkojë çdo informacion për veprimtarinë e Komitetit Konsultativ.

##### **Neni 22**

##### **Dorëheqja**

1. Kryesuesi, Zëvendës kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit Konsultativ mund të japin dorëheqje, duke i dhënë njoftim paraprak me shkrim tridhjetë (30) ditë më herët Kryesuesit të Komitetit, gjegjësisht Kryesuesi e njofton zëvendës kryesuesin.
2. Anëtari që jep dorëheqje duhet të kryej të gjitha detyrat deri në caktimin e anëtarit të ri nga Kuvendi.

### **Neni 23**

#### **Shkarkimi**

1. Kuvendi, mund t'i shkarkojë Kryesuesin, Zëvendës kryesuesi, dhe anëtarët e Komitetit Konsultativ nëse:
  - 1.1. është dënuar për vepër penale nga Gjykata Kompetente më shumë se gjashtë muaj;
  - 1.2. për shkak të shkeljes së legjislacionit në fuqi dhe shkeljeve të rregulloreve lokale;
  - 1.3. për shkak të sjelljeve të këqija.
2. Komiteti, me propozimin e Kryesuesit të Komitetit, ka të drejtë të propozojë largimin e anëtarit të Komitetit, nëse tri herë radhazi, pa arsye, nuk ka marrë pjesë në Takimet e Komitetit. Propozimi për largim i ofrohet Kuvendit të Komunës.
3. Komiteti me shumicë votash mund ta kërkojë nga Kuvendi që të shkarkoj secilin anëtar duke përfshirë edhe Kryesuesin dhe zëvendës kryesuesin e Komitetit Konsultativ nëse:
  - 3.1. nuk i kryen detyrat që i janë dhënë nga Komiteti Konsultativ;
  - 3.2. nëse e keqpërdor dhe neglizhon pozitën e tij si anëtar i Komitetit Konsultativ;
  - 3.3. Nuk merr pjesë pa arsye në tri (3) herë radhazi në takimit të Komitetit Konsultativ.
4. Para vendimit për shkarkim, anëtarit duhet dhënë e drejta për ndëgjim, ku ai duhet ofruar shpjegimin dhe arsyet e tij.

### **Neni 24**

#### **Takimet e Komitetit**

1. Takimet e Komitetit thirren nga Kryesuesi ose nga 1/3 e anëtarëve të Komitetit.
2. Komiteti Konsultativ mban takime sipas nevojës, po se paku katër takime në vit.
3. Komiteti duhet të hartojë kalendarin për takime për secilin vit, në të cilin duhet të përfshihen takimet e rregullta me Kuvendin dhe takimet e rregullta me Kryetarin.
4. Kryesuesi i Komitetit Konsultativ thërret dhe drejton takimet, drejton diskutimet dhe siguron zbatimin e kompetencave të Komitetit.
5. Komiteti në takime vendos për kohën dhe vendin e mbajtjes së takimeve.
6. Takimin e udhëheq Kryesuesi i Komitetit Konsultativ ose në mungesë të tij zëvendës kryesuesi i Komitetit Konsultativ e në mungesë të këtyre të dyve nga anëtar më i vjetër për nga mosha.

### **Neni 25**

#### **Njoftimi për takimet e Komitetit**

1. Kryesuesi i Komitetit, njofton me shkrim, së paku shtatë (7) ditë më herët, anëtarët e Komitetit Konsultativ, për kohën dhe vendin e mbajtjes së takimeve përveç rasteve të urgjencës.
2. Ftesa për takimet e Komiteteve, përmban:
  - 2.1. Rendin e ditës;
  - 2.2. Kohën dhe vendin e mbajtjes së takimit.
3. Rendi i ditës miratohet me shumicën e anëtarëve të pranishëm në takim.

4. Pas miratimit të rendit të punës miratohet procesverbali i takimit paraprak.
5. Komiteti procedon në takim me rendin e punës ashtu siç është miratuar.
6. Rendi i punës së Komitetit mund të ndryshohet dhe të plotësohet, nëse për këtë pajtohen më shumë se gjysma anëtarëve të Komitetit.

#### **Neni 26** **Kuorumi**

Komiteti ka kuorum nëse janë të pranishëm 2/3 e anëtarëve të Komitetit.

#### **Neni 27** **Marrja e vendimeve**

Vendimet e Komitetit Konsultativ merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në takimit. Nëse votat janë të barabarta vendos vota e Kryesuesit të Komitetit Konsultativ.

#### **Neni 28** **Procesverbali i takimit**

1. Për çdo takim të Komitetit mbahet procesverbal i cili miratohet në mbledhjen e radhës nga Komiteti.
2. Në procesverbal bëhet një përmbledhje e diskutimit, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.
3. Të gjitha çështjet për të cilat vendos Komiteti, përfshihen në procesverbalin e takimit, i cili miratohet në takimin pasues të Komitetit, nënshkruhet nga kryesuesi dhe janë obliguese për anëtarët e Komitetit.
4. Procesverbalin mund ta kenë secili nga anëtarët e Komitetit.

#### **Neni 29** **Parandalimi i konfliktit të interesit**

Kryesuesii, zëvendës kryesuesi dhe cilido anëtar i Komitetit nuk merr pjesë në shqyrtimin e ndonjë çështje për të cilën ai/ajo ka konflikt interesash, në pajtim me legjislacionin në fuqi për konfliktin e interesave.

#### **Neni 30** **Raporti vjetor**

1. Komiteti është i obliguar që të përgatisë dhe të dorëzojë raportin vjetor për vitin paraprak për punë e vet.
2. Raporti i dorëzohet Kuvendit të Komunës, më së largu deri në fund të muajit janar të vitit përkatës.

### **v. MBËSHTETJA E KOMITETIT KONSULTATIV**

#### **Neni 31** **Bashkëpunimi**

1. Për të siguruar kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të Komitetit, të gjitha organet komunale dhe të gjithë zyrtarët komunal janë të obliguar që të bashkëpunojnë me Komitetin dhe t'i ofrojnë përkrahjen e nevojshme.

2. Të gjitha projekt aktet e komunave që hartohen duhet t'i dorëzohen Komitetit Këshillëdhënës.

### **Neni 32** **Aktivizimi i Komitetit**

Komitetet duhet të jenë aktive dhe t'i paraqesin dhe t'i përfaqësojnë pikëpamjet, mendimet dhe interesat e qytetarëve tek Kryetari dhe në Kuvend në fushën e veprimit të tyre si dhe duhet të bëjnë propozime për përmirësimin, apo zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

### **Neni 33** **Sigurimi i bashkëpunimit**

Kryetari siguron që komitetit t'i ofrohen në dispozicion mjete e nevojshme buxhetore administrative dhe logjistike në mënyrë që komiteti të ketë mundësi të kryejë punën e tij në mënyrë efikase, duke përfshirë edhe sigurimin e hapësirave/zyrave për mbajtjen e takimeve të Komiteteve.

## **VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 34** **Kundërthëniet**

Në të gjitha rastet kur ka kundërthënie të kësaj Rregulloreje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ nr. 2008/10 për organizimin dhe funksionimin e Komiteteve Konsultative në komuna, dhe dispozitat e Statutit të Komunës do të zbatohen dispozitat e ligjit, Udhëzimit dhe Statutit.

### **Neni 35** **Zbatimi**

Kjo rregullore zbatohet nga të gjitha organet dhe punonjësit e Komunës së Vitisë.

### **Neni 36** **Funksionimi dhe organizimi punës së Komitetit Konsultativ**

Në përputhje me përgjegjësitë të cilat dalin nga kjo rregullore edhe legjislacionit në fuqi, Komiteti më shumicë të votave mund të miratojë rregullat e brendshme të punës me kush që nuk bien në kundërshtim me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

### **Neni 37** **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale.

**Kryesues i Kuvendit Komunal**  
**Naim Pira**

